



FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

CIKLI II MASTER I SHKENCAVE BIOLOGJI MOLEKULARE
PROGRAMI I LËNDËS: TOKSIKOLOGJI

Aktiviteti mësimor	Leksione	Seminare	Laboratore	Praktikë	Totale
Detyrimi i studentit	Jo të detyrueshëm	75%	100%	0	0
Orë mësimore	15	15	15	0	45
Studim individual	55				
Gjuha e zhvillimit të mësimit	Shqip				
Tipologjia e lëndës / Lloji i lëndës / Kodi i lëndës	C / E detyrueshme /				
Kodi i etikës	Referuar Kodit të etikës së UT, miratuar me Vendim Nr.12, datë 18.04.2011				
Mënyra e shlyerjes	VLV				
Kredite	4				
Zhvillimi i Mësimit	Viti I, Semestri I, 15 javë: 1 orë leksion/1 orë seminar/ 1 orë laborator/ javë				
Zhvillimi i Provimit	Kontroll i vazhduar, 50% pikëve detyrim, 45-50 pike nota pesë, çdo dhjetë pikë vlerësimi shtohet me një notë.				
Vlerësimi, Nota VLV	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10%			
	Detyra kursi	10%			
	Laboratore	10%			
	Kontrolle 1	20%			
	Kontrolle 2	25%			
	Kontrolle 3	25%			
	Gjithsej	100%			

Konceptet themelore	Toksikologjia është studimi i helmeve, ose më gjerë, identifikimi dhe përcaktimi i rezultateve negative të shoqëruara me ekspozimet ndaj agjentëve fizikë, substancave kimike dhe kushteve të tjera. Si e tillë, toksikologjia bazohet në shumicën e shkencave themelore biologjike, disiplinave mjekësore, epidemiologjisë dhe disa fushave të kimisë dhe fizikës për informacione, dizajne dhe metoda kërkimore. Toksikologjia varion nga hetimet bazike të hulumtimit mbi mekanizmin e veprimit të agjentëve toksikë nëpërmjet zhvillimit dhe interpretimit të testeve standarde që karakterizojnë vetitë toksike të agjentëve.
Objektivat	Gjatë zhvillimit të lëndës, studenti njihet me modelet toksiko-kinetike dhe toksikodinamike të substancave toksike në organizëm, Mënyrën se si përthithet, shpërndahet e më pas eliminohet një lëndë e huaj ksenobiotike. Efektet toksike mbi organe specifike dhe ndikimin që kanë lëndë të ndryshme në sistemet kryesore si sistemi nervor dhe ai endokrin.
Njohuritë paraprake	Njohuritë e fituara gjatë Ciklit të Parë të Studimeve.